VENDIM
Nr. 228, datë 23.3.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PEDONALJA E QYTETIT, URA VAJGURORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Pedonalja e qytetit, Ura Vajgurore".
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Ura Vajgurore.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë truall" dhe "ndërtesë", me vlerë të përgjithshme prej 1 574 002 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dy) lekësh.
4. Vlera totale e shpronësimit, prej 1 574 002 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dy) lekësh, të përballohet nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë, sipas nenit 10, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Ura Vajgurore.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Ura Vajgurore, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.
10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia Ura Vajgurore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

TABELA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT

Rehabilitim, ndriçim i shëtitores së lagjes "18 Tetori", "Ura Vajgurore", "Pedonalja e qytetit"

	Pronari					Sipërfaqja		Çmimi		Vlera		
						truall	ndërtim	truall	ndërtim	truall	ndërtim	
Nr.	**Emri**	**Mbiemri**	**Zona kadastrale**	**Nr. i pasurisë**	**Lloji i ndërtimit**	m²	m²	lekë	lekë	lekë	lekë	**Shënime**
1	ZENEPE	KASA	3682	2/733	SHËRBIM	30	30	2646	situacion	79380	1494622	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
						30	30			79,380	1,494,622	
								VLERA TOTALE			**1,574,002**	**Lekë**